



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 3 gusht 2020
Nr. Ref.:RK 1593/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI64/20

Parashtrues

Asllan Meka

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjkimit të Gjykatës Supreme,
Rev. nr. 2/2020, të 19 shkurtit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Asllan Meka nga Gjakova (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [Rev. nr. 2/2020] të 19 shkurtit 2020 të Gjykatës Supreme.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) si dhe me nenin 1 [E drejta e Pronës] të Protokollit I, dhe me nenet 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] dhe 13 [E drejta për ankim efektiv] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 47 [Kërkesat Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 59 [Llojet e vendimeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 21 prill 2020, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 19 maj 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues) Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi, anëtarë.
7. Më 28 maj 2020, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai plotësimin e formularit të kërkesës, dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.
8. Më 17 qershor 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë formularin e plotësuar të kërkesës së bashku me disa dokumente tjera.
9. Më 22 korrik 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Sipas shkresave të lëndës, më 26 shkurt 2008, parashtruesi i kërkesës, së bashku me tre persona të tjerë, E.M, S.M dhe SH.K.M, si huamarrës, lidhi kontratën mbi huan me paditësin A.K., si huadhënës, sipas së cilës pranuan huan në shumë prej 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) euro, me afat të kthimit prej 1 (një) viti.
11. Në një datë të paspecifikuar, pasi që huamarrësit nuk ia kishin kthyer borxhin, huadhënësi A.K paraqiti padi pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) kundër parashtruesit të kërkesës dhe huamarrësve të tjerë, E.M, S.M dhe SH.K.M, për kthimin e borxhit prej 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) euro.
12. Më 2 mars 2015, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C. nr. 301/14] miratoi në tërësi kërkesën e paditësit A.K, dhe detyroi solidarisht parashtruesin e kërkesës dhe të paditurit tjerë E.M, S.M dhe Sh.K.M, që në emër të kthimit të borxhit në bazë të kontratës mbi huan, t'ia paguajnë paditësit shumën prej 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) euro, me kamatë përkatëse ligjore, e cila fillon të rrjedhë nga data 24.03.2010 e tutje, e deri në pagimin definitiv, në lartësi të cilën e paguajnë bankat komerciale në Kosovë për mjetet e deponuara në bankë.
13. Më 8 prill 2015, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit [C. nr. 301/14] të 2 marsit 2015 të Gjykatës Themelore, me kërkesë që aktgjykimi i ankimuar të prishet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
14. Më 8 nëntor 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [CA. nr. 1774/2015] refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe të paditurve tjerë, dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.
15. Më 27 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion pranë Gjykatës Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe asaj Themelore, duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave kontestimore dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.
16. Më 19 shkurt 2020, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 2/2020] refuzoi si të pathemeltë revizionin e parashtruesit të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [Rev. nr. 2/2020] të 19 shkurtit 2020 të Gjykatës Supreme, me pretendimin se i njëjti është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], dhe 102

[Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës si dhe me nenin 1 të Protokollit I, dhe nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së.

18. Parashtruesi i kërkesës iu referohet neneve të lartcekura të Kushtetutës dhe KEDNJ-së duke pretenduar shkelje të të drejtave themelore të garantuara me këto nene, mirëpo pa shtjelluar dhe arsyetuar fare se si dhe pse janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me këto nene të Kushtetutës dhe KEDNJ-së.
19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta përmes aktgjykimeve të nxjerra *“i kanë mbrojtur fajdet”*. Ai thekson se të hollat i janë dhënë me fajde, dhe se arsyetimet e dhëna në aktgjykimet e gjykatave të rregullta janë të paqarta dhe kontradiktore.
20. Tutje parashtruesi pretendon se (i) gjykatat e rregullta nuk kanë vlerësuar tërësisht ankesat e tij, siç janë të detyruara me nenin 204 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK-së); (ii) ne kemi qenë katër të paditur dhe në gjykatë kurrë nuk janë ftuar i padituri 2, 3 dhe 4 por vetëm i padituri i parë; (iii) gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar se ku janë marrë dhe dhënë të hollat; dhe se (iv) kontratat janë fiktive dhe të imponuara. Sipas parashtruesit të kërkesës asgjë nuk ishte vërtetuar nga ana e gjykatave dhe për këtë arsye padia është dashtë të hedhet poshtë.
21. Pretendim tjetër i parashtruesit të kërkesës është edhe ajo që sipas tij paditësi ka ushtruar padi në vitin 2014 ndërsa ai obligohet që ta paguaj kamatën nga viti 2003. Ai thekson se ky borxh është parashkruar por kundërshtimi i parashkrimit nuk është trajtuar. Sipas parashtruesit *“Çështja e parashkrimit deri me datën 22 mars 1999 ka qenë e rregulluar me LMD, neni 371, dhe afati i parashkrimit ishte 5 (pesë) vjet. Andaj, dispozita e nenit 34. të Ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për marrëdhëniet detyimore “Gazeta zyrtare e RFJ” 31/93 e dt. 18.06.1993 e cila ka hype ne fuqi me dt. 25.06.1993 e cila dispozitë e rregullon ndryshe atë lëmi nga ajo e rregulluar me dispozite ligjore në fuqi deri me 22 mars 1999 është dispozitë e pa aplikueshme, e cila as përjashtimisht nuk mund të aplikohet, pavarësisht se është jodiskriminuese, prej nga del se neni 34 i Ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për marrëdhëniet detyimore “Gazeta zyrtare e RFJ” 31/93 i dt. 18 qershor 1993 është ligj për Kosovë i pa aplikueshëm”*.
22. Në fund parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të anulohen dhe të shpallen *“antikushtetuese”* Aktgjykimet e Gjykatave të rregullta.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

23. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
24. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

25. Gjykata, më tej, i referohet neneve 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49
[Afatet]

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.[...]

26. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev. nr. 2/2020] e 19 shkurtit 2020 të Gjykatës Supreme; ka saktësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur; ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, si dhe, e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar ligjor.

27. Megjithatë, përveç këtyre kritereve, Gjykata po ashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

28. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 2/2020] të 19 shkurtit 2020

i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 31, 32 dhe 102 të Kushtetutës si dhe me nenin 1 të Protokollit I dhe nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së.

29. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës, në substancë, ankohet se në rastin e tij nuk ka pasur gjykim të drejtë dhe të paanshëm për arsye se gjykatat e rregullta nuk kanë marrë për bazë faktet e paraqitura dhe nuk kanë shqyrtuar tërësisht ankesat e tij. Po ashtu parashtruesi pretendon se kontratat ishin fiktive dhe të imponuara, dhe se këtu kemi të bëjmë me fajde dhe jo me huadhënie. Sipas parashtruesit, Gjykata Supreme ka bërë interpretim të gabuar të ligjit kur ka vendosur që të paguhet kamata nga viti 2003, për shkak se sipas tij padia është bërë në vitin 2014 dhe se gjithmonë kamata aplikohet nga dita e parashtrimit të padisë.
30. Lidhur me pretendimet e lartcekura, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës në thelb thekson vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale nga gjykatat e rregullta. Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit janë në kundërshtim me dokumentacionin e paraqitur nga vetë parashtruesi në Gjykatë.
31. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit se kamata nga kontrata mbi huan është *“me fajde”* dhe se rrjedhimisht *“e tërë kontrata është me fajde”*, Gjykata vëren se këto pretendime të parashtruesit janë të pasakta sepse me Aktgjykimin e shkallës së parë është përcaktuar se parashtruesi është i detyruar të paguajë *“...kamatën përkatëse ligjore të cilat e paguajnë Bankat Komerciale në Kosovë për mjetet e deponuara në bankë, në afat mbi një vit...”*.
32. Gjithashtu, parashtruesi pretendon se gjykata e detyroi atë që të paguajë borxhin dhe kamatën prej vitit 2003, dhe se gjykata nuk e mori parasysh parashkrimin e kërkesës, por Gjykata vëren se këto pretendime të parashtruesit nuk janë të sakta sepse me Aktgjykimin e shkallës së parë është përcaktuar se detyrimi i pagesës së kamatës *“...fillon të rrjedhë nga data 24.03.2010, e tutje, gjer në pagimin definitiv...”*.
33. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e *“shkallës së katërt”*, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në përputhje me praktikën e GJEDNJ dhe po ashtu edhe me praktikën e saj tanimë të konsoliduar, Gjykata rithekson se është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të ligjit procedural dhe material dhe se nuk mund të bëhen vlerësime abstrakte se pse një gjykatë e rregullt ka vendosur në një mënyrë të caktuar e jo në një tjetër (Shih, rasti *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, par. 28-30 dhe shih, gjithashtu rastin: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011, paragrafët 29-30).
34. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse në një proces provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara

në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të atillë që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, ndër autoritete të tjera, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, aktgjykim i 16 dhjetorit 1992, paragrafi 34).

35. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në Aktvendimin e Gjykatës Supreme është i qartë dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu gjeti që procedurat para Gjykatës së Apelit dhe asaj Themelore nuk ishin të padrejta apo arbitrare (Shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, Nr. 17064/06, Vendimi i GJEDNJ-së, i 30 qershorit 2009).
36. Në rrethanat e rastit konkret në mënyrë që edhe më konkretisht të elaborohen parimet e përgjithshme të gjyimit kushtetues, Gjykata vëren se të gjitha gjykatat e rregullta kishin adresuar të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës të parashtruara me përgjigje në padi, ankesë dhe revizion.
37. Për sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit të saj [C. nr. 301/14] të 2 marsit 2015, ndër të tjera, kishte theksuar:

“Nga Kontrata e mjeteve monetare e lidhur me datë 26.02 .2008, në mes të kontraktueseve Afrim Kumnova, në cilësi e huadhënësit (paditësit në rastin konkret) dhe të Asllan Meka, Enver Meka, Saranda Meka, Shahindere Koshi (e vajzërisë Meka), nga Gjakova dhe Zyrafa Meka - tani ish nga Gjakova si huamarrës (te paditurit në rastin konkret), - me përjashtim të tani të ndjerës Zyrafa Meka, e cila në ndërkohe ka vdekur dhe të cilën e pas jetojnë të paditurit 1-4, vërtetohet se huadhënësi Afrim iu ka dhënë hua huadhënësve të lartë përmendur shumën prej 35.000,00 €, me afat të kthimit pas një viti, nga dita e nënshkrimit të kontratës së lartë cituar. Kontrata lëndore është firmosur nga të gjithë kontraktuesit, dhe çështja e nënshkrimit të tyre nuk kontestohet fare nga palët në procedurë gjate shqyrtimit të kësaj çështje.

Kjo Gjykatë në rastin konkret konsideron se të paditurit deri në momentin e shqyrtimit kryesor me asnjë provë materiale nuk argumentuan faktin se ia kanë paguar paditësit shumën e monetave. Pra duke u nisur nga parimi juridik se: Kontrata është ligj për palët (“pacta sunt servanda”) rezulton se të njëjtit kanë obligim ligjor që paditësit t’ia kthejnë shumën e marrë hua, lartësinë prej 35.000,00 euro, së bashku me kamatën gjegjëse ligjore dhe shpenzimet aksesore siç janë përcaktuar në dispozitivin e këtij aktgjykimi. Në favor të këtij konstatimi të Gjykatës qëndron edhe fakti se këtu të paditurit në asnjë mënyrë dhe në asnjë rrethanë nuk e kontestonin faktin e nënshkrimit të tyre në kontratën lëndore edhe në dëftesën nr. 01/2008 të datës 26.02.2008 ku i kanë pranuar monetat e dhëna hua nga paditësi”.

38. Duke adresuar pretendimet e ngritura me ankesë, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit të saj [CA. nr. 1774/2015] të 8 nëntorit 2019, ndër të tjera, kishte theksuar:

“Kolegji, konstaton se gjykata e shkallës së parë gjatë zbatimit të procedurës kontestimore, nuk ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, për të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare, e as shkelje tjera procedural që do të ishin me ndikim në vendimmarrje të drejtë në këtë çështje juridike.

Kolegji, vlerëson se të paditurit, pretendimet e tyre ankimore, nuk i provuan me fakte relevante, të besueshme dhe të mjaftueshme, edhe përkundër faktit se e kishin barrën e provës, andaj ankesa e tyre është e pa themeltë dhe si e tillë u refuzua”.

39. Më saktësisht, Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj kishte theksuar si në vijim:

“Gjykata Supreme e Kosovës i ka vlerësuar si të pabazuara thëniet e të paditurit në revizion, se aktgjykimi i goditur është marrë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2(n), ngase siç theksohet dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptimtë dhe ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe se dispozitivi është në kundërshtim me arsyet, përkatësisht aktgjykimi i atakuar nuk ka arsye mbi faktet vendimtare. Sipas vlerësimit të gjykatës së revizionit, aktgjykimi i goditur nuk është përfshirë me shkelje të tilla të procedurës, sepse dispozitivi i aktgjykimit është në pajtim me provat e administruara, kur gjykata ankimore ka gjetur se të paditurit nuk kanë përmbushur detyrimin e tyre nga kontrata e huas, ngase nuk ia kanë kthyer paditësit shumën prej 35.000 euro, në afatin e caktuar në kontratë. Të paditurit me asnjë provë nuk kanë argumentuar faktin se paditësit ia kanë kthyer shumën e huazuar. Me nenin 557 janë përcaktuar kushtet thelbësore për lidhjen e kontratës mbi huan dhe atë: “Me kontratën e huas obligohet huadhënësi t’ia dorëzojë në pronësi, respektivisht në deponim huamarrësit shumën e caktuar të hollash ose sasinë e caktuar të sendeve të tjera të zëvendësueshme, ndërsa huamarrësi obligohet t’i kthejë pas një kohe të caktuar të njëjtën shumë të hollash, respektivisht të njëjtën sasi sendesh të llojit dhe cilësisë së njëjtë mbi sendet e marra huamarrësi fiton të drejtën e disponimit respektivisht të drejtën e pronësisë”. Nga kontrata e lidhur në mes ndërgjyqësve del se paditësi si huadhënës u ka dhënë të paditurve shumën e të hollave, me obligim që në afatin e caktuar t’ia kthejnë dhe se me këtë paditësi ka përmbushur detyrimin ndaj të paditurve, ndërsa të paditurit me moskthimin e shumës së huas, nuk kanë përmbushur detyrimin ndaj paditësit dhe janë të obliguar që t’ia kthejnë huan me shumë prej 35.000 euro”.

40. Rrjedhimisht dhe siç është elaboruar më lartë, Gjykata vëren që të gjitha gjykatat e rregullta kishin adresuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe kishin konstatuar se shuma prej 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) euro ishte marrë hua nga ana e parashtruesit të kërkesës dhe personave E.M, S.M dhe SH.K.M nga paditësi A.K, gjë që vërtetohet përmes kontratës së lidhur mes tyre dhe dëftesës së dorëzimit të të hollave, dhe se kjo shumë duhet ti kthehet huadhënësit.

41. Në këtë aspekt, Gjykata më tej konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se procedurat në Gjykatën Supreme apo në gjykatat e tjera të rregullta kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë themelore të tij të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të së drejtës procedurale. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit është detyrë e gjykatave të rregullta dhe është çështje e ligjshmërisë. (Shih, rasti KI63/16, parashtrues i kërkesës *Astrit Pira*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 gushtit 2016, paragrafi 44 dhe shih, gjithashtu rastin KI150/15; KI161/15; KI162/15; KI14/16; KI19/16; KI60/16 dhe KI64/16, parashtrues të kërkesës *Arben Gjukaj, Hysni Hoxha, Driton Pruthi, Milazim Lushtaku, Esat Tahiri, Azem Duraku dhe Sami Lushtaku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 nëntorit 2016, paragrafi 62).
42. Gjykata gjithashtu rithekson se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk i garantojnë askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe as nuk përcaktojnë që Gjykata ta vë në diskutim zbatimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta të një kontesti civil, ku kryesisht njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb. (Shih rastet e Gjykatës KI118/17 parashtrues *Şani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 janarit 2018, paragrafi 36; dhe KI99/19, parashtrues *Persa Raičević*, Aktvendim për Papranueshmëri i 19 dhjetorit 2019, paragrafi 48).
43. Në linjë me praktikën e saj të konsoliduar gjyqësore, Gjykata më tej thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta, përkatësisht me vendimet e Gjykatës Supreme, të Apelit dhe atë Themelore, nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. (Shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21,; dhe shih, gjithashtu rastin KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).
44. Përkitazi me pretendimet për shkelje të neneve 32 dhe 102 të Kushtetutës, si dhe të nenit 1 të Protokollit I dhe nenit 13 të KEDNJ-së, Gjykata thekson se vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës dhe KEDNJ-së, nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës dhe KEDNJ-së, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse. (Shih, në këtë kontekst, rastin e Gjykatës KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33).
45. Si rezultat, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe që me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ.
46. Si përfundim, në pajtim rregullin 39 (2) të Rregullores së punës kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe, rrjedhimisht, e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 22 korrik 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Radomir Laban

Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

Arta Rama-Hajrizi